



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSCPR-2018

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 29 maj 2018

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Dosje e Administrimit Gjyqësor për 2018

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *Ex Parte*

VENDIM

për caktimin e një gjykatësi të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit

Gjykatës i vetëm

Gjykatësi Nikola Giju

Ushtrues i detyrës së Prokurorit të Specializuar

Kwai Hong Ip

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me anë të këtij vendimi cakton një gjykatës të vetëm për të shqyrtuar kërkesat për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to të parashtruara nga Prokurori i Specializuar përpara ngritjes së aktakuzës dhe caktimit në vijim të një gjykatësi të procedurës paraprake në bazë të nenit 33(1)(a) të Ligjit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 maj 2018, ushtruesi i detyrës së Prokurorit të Specializuar i dorëzoi Kryetares një kërkesë për caktimin e një gjykatësi të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit (“Kërkesa”).
2. Ushtruesi i detyrës së Prokurorit të Specializuar parashtron se për shqyrtimin e një kërkesë për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me të, që do të dorëzohet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në lidhje me një çështje hetimore, kërkohet caktimi i një gjykatësi të vetëm.

II. LIGJI I ZBATUESHËM

3. Neni 25 i Ligjit përcakton përbërjen e Dhomave, që përfshin, ndër të tjera, gjykatës individualë që kryejnë detyrën e gjykatësit të procedurës paraprake si dhe gjykatës individualë që kryejnë detyra të tjera që kërkohen me këtë Ligj.
4. Në bazë të nenit 33(1)(a), gjykatësi i procedurës paraprake caktohet me ngritjen e aktakuzës në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit.
5. Neni 33(2) i Ligjit parasheh që Kryetarja e Dhomave të Specializuara mund të caktojë një gjykatës të vetëm nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Regjistri”) në pajtim me Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve nga Regjistri

(“Rregullorja për Caktim”) për t’u marrë me çështje që, sipas mendimit të Kryetarit, kërkon caktimin e një gjykatësi që nuk është gjykatës i procedurës paraprake.

6. Caktimet në bazë të nenit 33(2) të Ligjit janë me natyrë të përkohshme dhe pushojnë sapo të jetë zgjidhur çështja për të cilën janë bërë caktimet.

7. Neni 33(4) i Ligjit kërkon që gjykatësi i caktuar si gjykatës i procedurës paragjyqësore apo anëtar i një paneli për një çështje, nuk mund të jetë anëtar i një paneli tjetër në një fazë tjetër të së njëjtës çështje.

8. Rregulla 3(1) e Rregullores për Caktim parasheh që gjykatësit e emëruar në Regjistër caktohen në panele nga Kryetarja, në përputhje me nenin 33 të Ligjit. Sipas rregullës 3(4), për caktimin e gjykatësve në një panel, Kryetarja nxjerr një vendim publik i cili përmban kriteret e caktimit, sikurse përcaktohet në rregullën 5(2) të Rregullores për Caktim.

III. CAKTIMI I NJË GJYKATËSI TË VETËM

9. Kërkesa e ushtruesit të detyrës së Prokurorit të Specializuar është dorëzuar përpara ngritjes së aktakuzës dhe caktimit në vijim të një gjykatësi të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit.

10. Si rrjedhojë, çfarëdo kërkesë e Prokurorit të Specializuar për autorizim gjyqësor që dorëzohet para ngritjes së aktakuzës nuk përfshihet në fushëveprimin e nenit 33(1)(a) të Ligjit.

11. Sipas neneve 25(1)(f) dhe 33(2) të Ligjit, të interpretuara bashkërisht, Dhomat mund të përfshijnë gjykatës të vetëm që kryejnë detyra të tjera që kërkohen në bazë të këtij Ligji, për t’u marrë me çështje të cilat, sipas mendimit të Kryetarit, kërkojnë caktimin e një gjykatësi që nuk është gjykatës i procedurës paraprake. Rrjedhimisht, qëllimi i këtyre dispozitave është që të ngërthejë ato raste kur është

i nevojshëm caktimi i një gjykatësi të vetëm për t'u marrë me një çështje specifike, pa u aktivizuar kushtet për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake në bazë të nenit 33(1)(a) të Ligjit.

12. Ligji dhe Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") ofrojnë disa shembuj joshterues të çështjeve të tilla: kërkesat në lidhje me kushtet e paraburgimit (neni 51(3) i Ligjit); kërkesa për pushimin e hetimit (rregulla 47(2) e Rregullores); kërkesa për ndryshim të masave mbrojtëse (rregulla 81(3)(b) e Rregullores); rishikimi i dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave në lidhje me riklasifikimin (rregulla 84(2) e Rregullores); kërkesa për dëshminë e një personi në paraburgim të Dhomave të Specializuara (rregulla 199(2) e Rregullores); kërkesa për transferimin e çështjeve gjyqësore nga gjykata të tjera të Kosovës tek Dhomat e Specializuara (rregulla 203(1) e Rregullores).

13. Përveç kësaj, disa dispozita të Rregullores parashikojnë që një "panel" vendos për kërkesa të ndryshme për autorizim gjyqësor, çka mund të nënkuptojë, ndër të tjera, edhe caktimin e një gjykatësi të vetëm: autorizimin nga paneli të marrjes së masave hetimore (rregullat 31-41 të Rregullores); lëshimin e fletarrestimeve, fletëthirrjeve për paraqitje për gjyq, vendimeve ose urdhrave të tjerë (rregulla 48(2) e Rregullores); transferimin në Dhomat e Specializuara (rregulla 50(1) e Rregullores); zhdëmtimin për arrestim ose paraburgim të paligjshëm (rregulla 51(2) e Rregullores); kërkesën për urdhër për informacion, bashkëpunim ose ndihmë (rregulla 201(1) e Rregullores).

14. Duke pasur parasysh fushëveprimin e gjerë të nenit 33(2) të Ligjit, kërkesa për autorizim gjyqësor parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së një aktakuze pa dyshim do të përfshihej në fushëveprimin e këtij neni.

15. Caktimet sipas nenit 33(2) të Ligjit janë të natyrës së përkohshme dhe pushojnë sapo të jetë zgjidhur çështja për të cilën janë bërë ato caktime. Në këtë rast, shkak

për caktimin e një gjykatësi të vetëm sipas nenit 33(2) është çfarëdo kërkesë për autorizim gjyqësor e parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së aktakuzës.

16. Për të siguruar zgjidhjen e shpejtë dhe efikase të çfarëdo kërkesë të tillë, gjykatësi i vetëm caktohet edhe për shqyrtimin e të gjitha kërkesave të ardhshme për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me të, parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së aktakuzës.

17. Në përputhje me nenin 33(4) të Ligjit, gjykatësi i vetëm i caktuar në vijim në këtë urdhër nuk mund të jetë anëtar i panelit në një fazë tjetër të së njëjtës çështje, përveçse si gjykatës i procedurës paraprake.

18. Përveç nëse Kryetarja vendos ndryshe, gjykatësi i vetëm i caktuar më poshtë në këtë urdhër ushtron funksionet zyrtare vetëm për marrjen e një vendimi për secilën kërkesë konkrete për autorizim gjyqësor ose çështje të lidhur me të, si edhe deri në marrjen e një vendimi të tillë dhe shpërblehet në përputhje me këtë.

IV. KRITERET PËR CAKTIM

19. Pasi janë marrë parasysh të gjithë kriteret e parashikuar në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktim, gjykatësi i vetëm caktohet në bazë të përvojës dhe ekspertizës përkatëse si dhe në bazë të disponueshmërisë së tij të tashme dhe të ardhshme.

20. Ndonëse rregulla 3(4) e Rregullores për Caktim parashikon që për caktimin e gjykatësve në një panel Kryetarja duhet të lëshojë një vendim publik që përmban edhe kriteret e caktimit, kjo kërkesë nuk mund të ketë përparësi mbi konsiderata vendimtare lidhur me konfidencialitetin e hetimeve të kryera nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, të cilat bëjnë që kërkesa dhe ky urdhër të jenë rreptësisht konfidenciale. Në pajtim me këtë, si kërkesa ashtu edhe ky urdhër

mund të riklasifikohen në një datë të mëvonshme, në përputhje me rregullat 82 deri 84 të Rregullores, në qoftë se dhe kur arsyet për klasifikimin e tyre të tanishëm pushojnë së vepruari.

PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA NË VIJIM ÇAKTON

gjykatësin Nikola Giju

si gjykatës të vetëm për shqyrtimin e çfarëdo kërkesë për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to, parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së aktakuzës dhe caktimit në vijim të një gjykatësi të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit.

/nënshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 29 maj 2018

Në Hagë, Holandë.